

KËRKESË
Nr. 704/10, datë 17.7.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën për disa shtesa në VKM-në nr. 823, datë 19.12.2022, “Për shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtimi i linjës 400 kV Shqipëri–Maqedoni e Veriut’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “truall+ndërtesë”, sipas VKM-së nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa vlerësimi i ndërtesës është llogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik, për pasuritë e llojit ‘ndërtesë banimi ose jobanimi’”, i ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 800,800 (tetëqind mijë e tetëqind) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Egra Ibrahim

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI “PËR DISA SHTESA NË VKM-në NR. 823, DATË 19.12.2022, “PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI ‘NDËRTIMI I LINJËS 400 kV SHQIPËRI-MAQEDONI E VERIUT’”

[illegible]